

19.02.2025

Ora 13:18

RENDI I DITËS

*“Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin nr. 6 ID, datë 11.02.2025,
të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione
të Konsoliduara/KRIIK”.*

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- **Stafi KQZ:** Znj. I. Osmanaj, znj. A. Agolli

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK, përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Në seancën e sotme publike kemi në rend dite për të shqyrtuar:

- Denoncimin me nr. 6, të regjistrit të denoncimeve, të KRIIK.

- Denoncimin me nr. 14, të regjistrit të denoncimeve, po të Organizatës KRIIK.

- Denoncimin me nr. 15, të regjistrit të denoncimeve, po të Organizatës KRIIK.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 6.

Znj. I. Osmanaj: Faleminderit! Kemi administruar denoncimin me nr. 6, me denoncues Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, KRIIK.

Subjekt i denoncuar:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 19.02.2025*

- Znj. Elisa Spiropali, Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë;
- Z. Engjëll Agaçi, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.

Objekti i denoncimit është marrja e hapave të nevojshëm për parandalimin e miratimit të Projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", propozuar nga zoti Nasip Naço. Pretendimet e denoncuesit janë si vijon: Më datën 23 dhjetor 2024, në Kuvendin e Shqipërisë është depozituar projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve". Ky projektligj është ende duke u diskutuar në komisione dhe pritet të miratohet në seancat e ardhshme plenare të Kuvendit të Shqipërisë. Projektligji ofron përfitime të drejtëpërdrejta për kategori të caktuara të popullsisë, konkretisht të atyre që vuajnë dënimin në sistemin peniteciar në vend". Me vendimin nr.101 datë 14.02.2025, u vendos fillimi i hetimit administrativ. Në kuadër të këtij hetimi, më datë 12.02.2025, nëpërmjet adresës së postës elektronike, personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Kuvendin e Shqipërisë dhe Kryeministritë ju është dërguar email, për të paraqitur pretendimet e tyre, në lidhje me çështjen objekt hetimi administrativ. Më datë 14.02.2025, kemi administruar pretendimet e personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Kryeministri, të cilët pretendojnë se:

"Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me shkresën nr. 4855/1, datë 9.01.2025, i ka dërguar për mendim Këshillit të Ministrave projektligjin joqeveritar "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", të ndryshuar", propozuar nga një deputet i Kuvendit. Vendimi i Këshillit të Ministrave për projektligjin joqeveritar nuk rezulton të kategorizohet si ndonjë lloj vendimmarrje/veprimtari e ndaluar gjatë periudhës kohore katër muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, pra nuk përfshihet në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 19.02.2025*

kategorinë e akteve të ndaluara në kuptim të nenit 91 të Kodit Zgjedhor”. Gjithashtu, në të njëjtën datë, kemi administruar pretendimet e personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Kuvendin e Shqipërisë, të cilët pretendojnë se: “Amendimet e propozuara synojnë të përmirësojmë efikasitetin në menaxhimin dhe funksionimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale. Kjo ndihmon më mirë në organizimin e burimeve njerëzore, logjistike dhe në menaxhimin më të mirë të sigurisë. Meqenëse efektet e ligjit nuk janë të menjëhershme dhe nuk do të jenë të dukshme gjatë kësaj periudhe, nuk mund të argumentohet se ligji ka qenë një mjet për të pasur përfitime elektorale. Ky element shton argumentin tonë që efektet e projektligjit nuk do të jenë të menjëhershme dhe nuk mund të kenë asnjë impakt në zgjedhjet e përgjithshme. Në kuadër të këtij denoncimi kemi bërë dhe një shqyrtim të listës së projektligjeve të përfshira në kalendarin e punimeve të Kuvendit të Shqipërisë për periudhën nga data 2 shkurt e vijues. Kemi konstatuar se një projektligj, konkretisht projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 92, datë 24.07.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, propozuar nga zoti Agron Duka, nuk do të duhet të miratohet se ka lehtësira fiskale, pasi parashikon rregullime të mënyrës së aplikimit të TVSH si dhe aplikimet që ka në sektorin e bujqësisë duke zbritur TVSH-në në rastin e autofaturimeve në transaksionin e fermerëve me persona të tatueshëm. Në lidhje me këtë denoncim, kemi thirrur palët, të cilët janë të pranishëm për t’u shprehur në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi administrativ.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e Kuvendit!

Znj. Kesiana Rusi, përfaqësuese Kuvendit të Shqipërisë: Përshëndetje, i nderuar Komisioner! Unë jam përfaqësuese e Kuvendit për denoncimin e bërë nga

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 19.02.2025*

Organizata KRIIK, në lidhje me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe atyre me paraburgim”, nismë kjo e një deputeti. Prapësimet i kemi sjellë pranë jush elektronikisht dhe nuk kemi pretendime shtesë. Në fjalën time dua të evidentoj, sepse projektligji i propozuar nuk cënon dispozitat e Kodit Zgjedhor, konkretisht nenin 91, pika 4 pasi ky projektligj nuk sjell përfitime të drejtë për drejta financiare, apo sociale për të dënuarit, por rregullon procesin e klasifikimit të tyre. Efektet e tij nuk janë të menjëhershme, pasi ky projektligj është parashikuar të hyjë në fuqi pas datës së zgjedhjeve dhe propozimi i tij është bërë para datës 11 janar 2025. Nuk do të zbatohet brenda harkut kohor të ndaluar. Projektligji është pjesë e një reforme administrative dhe jo një favor elektoral duke u bazuar në një nevojë të kahershme për përmirësimin e menaxhimit të sistemit peniteciar. Procedura legislative është ndjekur sipas parashikimeve të rregullores dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar kjo, pa një përshpejtim të qëllimshëm, ose hyrja në fuqi të menjëhershme. Natyra e kufizuar e përfituesve, mungesa e efekteve të menjëhershme dhe mungesa e favorizimit elektoral janë faktorë që tregojnë qartë se ky projektligj nuk ka qenë një mjet për përfitime elektorale. Për sa parashtrova më sipër, kërkojmë rrëzimin e denoncimit të KRIIK si të pabazuar në ligj dhe në prova, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Të tjera pretendime nuk kemi në lidhje me këtë? Jo?!
Po zonja Arbi!

Znj. M. Arbi, përfaqësuese e Kuvendit të Shqipërisë: I nderuar Komisioner, në lidhje me konstatimet që ka bërë administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, referuar kalendarit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 92/2014 “Tatimi mbi

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 19.02.2025*

vlerën e shtuar”, të propozuar nga deputeti Agron Duka është e njëjtë me atë që Komisioneri është shprehur njëherë, është nisma e zotit Braçe, që është shprehur në pikën 2 të vendimit nr. 83. Kështu që është pa kuptim marrja e një vendimi përsëri për të njëjtin ligj.

Z. I. Celibashi: Bëhet fjalë për tjetër, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9817, datë 22.10.2017 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”.


Znj. M. Arbi, përfaqësuese e Kuvendit të Shqipërisë: Jo, është “Për tatimin për vlerën e shtuar”. Është e njëjta me nismën për të cilën jeni shprehur më parë si Komisioner. Pavarësisht se janë dy deputetë të ndryshëm që kanë depozituar.

Z. I. Celibashi: Jo, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9817”? është dhe ky?

Znj. M. Arbi, përfaqësuese e Kuvendit të Shqipërisë: Për këtë tjetrin nuk kam informacion.

Z. I. Celibashi: Mirë, do ta verifikojmë këtë propozimin e deputetit Duka, në qoftë se bëhet fjalë për një çështje që ne kemi vendosur, dakord! Kemi gjë tjetër? Nuk kemi! Mirë, faleminderit! Vlerësoj që edhe denoncimi i paraqitur nga KRIIK në lidhje me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosur”, pavarësisht argumenteve që u parashtruan nga ana e përfaqësuesve të Kuvendit, vlerësoj që është në kushtet që nuk do të përfshihet në procesin e shqyrtimit. Kodi Zgjedhor nuk e lidh fare me momentin e prodhimit të efekteve të një ndryshimi ligjor, e lidh me

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 19.02.2025*

propozimin dhe shqyrtimin. Propozimi dhe shqyrtimi në këtë periudhë kohore është i ndaluar kur vihet re se krijon përfitime për kategori të caktuara, kur ka ulje taksash dhe tatimesh. Ndaj dhe për këtë rast do t'i rekomandojmë Kuvendit të Shqipërisë që të mos e përfshijë në seancë për shqyrtim këtë projektligj. Faleminderit.

Vendim nr. 117

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



19.02.2025

Ora 13:28

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin administrativ bazuar denoncimin nr. 14 ID, datë 12.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- **Stafi KQZ:** Znj. I. Osmanaj, znj. A. Agolli

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK, përfaqësues të subjekteve të denoncuara.

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Znj. I. Osmanaj: Kemi administruar denoncimin me nr. 14 ID, me denoncues Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara
Subjekte të denoncuara janë:

- Z. Erlind Sulo, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore;
 - Z. Maksim Et’hemaj, Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil;
 - Z. Gentian Gjyli, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar;
 - Z. Ani Hasa, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Efiçencën e Energjisë;
 - Z. Kreshnik Bajraktari, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit Portual
- Durrës.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 19.02.2025*

Objekti i Denoncimit është përdorimi në postimet e aktiviteteve institucionale të disa Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të sloganeve/hashtag-eve partiakë/elektoralë

Denoncuesi në pretendimet e tij, pretendon se:


Përgjatë gjithë periudhës parazgjedhore, në faqet zyrtare në “Facebook” të disa Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë janë duke u përdorur slogane elektorale të Partisë Socialiste, në formën e hashtag-eve. Këto slogane është vërejtur se i përmban faqja zyrtare, e institucione në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si:

- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
- Autoriteti i Aviacionit Civil;
- Autoriteti Rrugor Shqiptar;
- Agjencia për Efiçencën e Energjisë;
- Autoriteti Portual Durrës.

Me vendimin nr. 94 datë 14.02.2025, Komisioneri vendosi fillimin e hetimit administrativ. Në kuadër të këtij hetimi ju është dërguar kërkesë për informacion, për të paraqitur pretendimet e tyre, palëve-subjekt hetimi administrativ. Më datë 17.02.2025, kemi administruar pretendimet e personave përgjegjës të cilët në tërësi deklarojnë se:

Postimet në fjalë nuk janë produkt i drejtëpërdrejtë i institucionit, por shpërndarje e postimeve që lidhen me aktivitetin e MIE, të marra nga faqet e znj. Belinda Balluku. Rrjedhimisht ne nuk kemi mundësi të ndërhyrë në këto postime dhe hashtagët pasqyrohen në mënyrë automatike. Gjithësesi menjëherë pasi është konstatuar kjo situatë kemi kontaktuar me stafin e znj. Balluku, të cilët kanë hequr hashtagët nga postimet, duke bërë të mundur ndryshimin e situatës edhe në faqet tona. Palët në proces hetimi administrativ janë njoftuar për të marrë pjesë në seancën e sotme

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 19.02.2025*

publike, për të parashtruar pretendimet e tyre në lidhje me çështjen objekt hetimi.

Sot në seancë janë paraqitur:

Përfaqësuesja e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore;

Përfaqësuesja e Autoritetit të Aviacionit Civil;

Përfaqësuesja e Agjencisë për Efiçencën e Energjisë;

Përfaqësuesja e Autoritetit Portual, Durrës;


Përfaqësuesja e Autoritetit Rrugor Shqiptar.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, duke filluar nga e djathta deri në vijim, fjala për secilin prej përfaqësuesve, duke u prezantuar me emrin dhe në çfarë kapaciteti jeni në këtë proces.

Znj. P. Ago, përfaqësuese e Autoritetit Rrugor Shqiptar: Petrina Ago, përfaqësuese e Autoritetit Rrugor Shqiptar. Vij si përfaqësuese e zotit Gentian Gjyli në lidhje me email-in që na ka ardhur për përdorimin e hashtagëve. Atëherë, siç ju kemi kthyer përgjigje edhe zyrtarisht si institucion, por dhe vetë drejtori i përgjithshëm, postimet nuk janë prodhim i institucionit, apo të ndonjë personi. Janë postime të marra ashtu siç pasqyrohet gjithë programi dhe kalendari i Ministrisë së Infrastrukturës, por dhe i zonjës ministre, Belinda Balluku. Ne rrjedhimisht nuk mund të ndërhyjmë dot në këto postime, por i kemi shpërndarë ashtu siç kanë qenë të prodhuara. Menjëherë sapo është bërë me dije kjo, të gjitha postimet janë edituar dhe janë hequr hashtagët. Rrjedhimisht dhe në faqet tona që janë shpërndarë, kanë ikur hashtagët siç ua kemi nisur dhe me email.

Z. I. Celibashi: Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 19.02.2025*

Znj. P. Ago, përfaqësuese e Autoritetit Rrugor Shqiptar: Faleminderit Ju!

Përfaqësuesi i Agjencisë për Efiçencën e Energjisë: I nderuar Komisioner! Siç tha dhe parafolsja kolegia, mua më duhet që Agjencia për Efiçencën e Energjisë, ditën e djeshme ka nisur email-in të cilin ne e konsiderojmë shterrues, me përgjigjen tonë. Mendojmë se i japim përgjigje dhe denoncimit të kryer nga KRIIK. Nuk kam gjë për të shtuar, përveç asaj që kemi shkruar dje. Kam sjellë dhe një kopje sot, në rast se duhet ta depozitojmë këtu, faleminderit.

Znj. D. Zanieli, përfaqësuese e Autoritetit të Aviacionit Civil: I nderuar Komisioner, përfaqësoj Autoritetin e Aviacionit Civil, Daniela Zanieli. Si pikë kontakti për raportimet në KQZ, koordinatore e të drejtës së informimit, vij në statusin e Autoritetit të Aviacionit Civil për t'ju parashtruar sërish një përgjigje shterruese duke i qëndruar stoik përgjigjes së dhënë të prapësimeve, brenda 48-orëshit të vendosur nga ana juaj. Nuk kemi asnjë kundërshtim apo pretendim tjetër mbi email-in për të shtuar, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Dakord, faleminderit! Porti i Durrësit!

Znj. Sonila Toska, përfaqësuese e Autoritetit Portual, Durrës: I nderuar zoti Komisioner, unë jam Sonila Toska, përfaqësuese e Autoritetit Portual, Durrës, vij në emër të drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv, zotit Kreshnik Bajraktari. Jam gjithashtu edhe personi i autorizuar për raportimet në KQZ. Pa dashur të përsëris kolegët nga institucionet e tjera, i qëndrojmë shpjegimeve që kemi dhënë edhe në shkresën zyrtare drejtuar KQZ-së, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 19.02.2025*

Z. I. Celibashi: Faleminderit!

Z. D. Babalino, përfaqësues i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore: I nderuar zoti Kryetar, për AKBN, përfaqësues Dritan Babalino dhe Shpendi Gjana: Edhe ne i përmbahemi shpjegimeve që kemi dhënë nëpërmjet email-it tonë duke evidentuar edhe njëherë faktin që ne pas këtij konstatimi AKBN-ja menjëherë ka marrë masat e saj dhe aktualisht nuk konstatohen më të njejtat që janë konstatuar nga subjekti, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Nuk kemi të tjerë përfaqësues, këta janë të gjithë?! Mirë, faleminderit! E kemi këtë konstatim që të gjitha këto postimet janë fshirë?

Znj. I. Osmanaj: Nga hetimi administrativ i bërë nga ana jonë, rezulton që të gjitha postimet e bëra në faqen zyrtare të institucioneve, subjekt denoncimi janë fshirë.

Z. I. Celibashi: Duke marrë në konsideratë edhe shpjegimet e përfaqësuesve të agjencive të denoncuara, duke mos pasur asnjë shkak për të mos besuar në sinqeritetin e këtyre deklarimeve sipas të cilave, këto postime janë rrjedhojë e pakujdesisë dhe mungesës së vëmendjes për të parë përmbajtjen e tyre. Gjendur në kushtet e mungesës së faktit, që këto postime tashmë nuk janë, vlerësoj që ka vend për të vendosur pushimin e shqyrtimit administrativ për këtë rast.

Vendim nr. 112

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 19.02.2025*

19.02.2025

Ora 13:35

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin administrativ bazuar denoncimin nr. 15 ID, datë 13.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Staf i KQZ: Znj. I. Osmanaj, znj. A. Agolli

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK, përfaqësues të subjekteve të denoncuara.

Z. I. Celibashi: Kalojmë te pika tjetër!

Znj. I. Osmanaj: Kemi administruar denoncimin me nr. 15 ID, me denoncues: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara. Subjekte të denoncuara janë:

Z. Gerti Janaqi, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.


Znj. Rezarta Alla, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar.

Z. Hasbi Lika, Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë.

Znj. Zaira Gjika, Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier.

Znj. Bora Sala, Drejtorja i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 19.02.2025*


Denoncuesi e bën këtë denoncim, sepse faqet zyrtare në facebook të disa institucioneve të varësisë së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit janë duke u përdorur sloganet elektorale të Partisë Socialiste. [SEP] Këto slogane është vërejtur se i përmban faqja zyrtare, e:

- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar;
- Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar; [SEP]
- Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë, Fier dhe Durrës. [SEP]

Nëpërmjet vendimit nr. 91, datë 14.02.2025, kemi vendosur fillimin e hetimit administrativ. Në kuadër të hetimit administrativ, më datë 13.02.2025, nëpërmjet adresës email personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në institucionet subjekt denoncimi ju është dërguar email, për të paraqitur pretendimet e tyre, në lidhje me këtë çështje. Brenda afateve ligjore kemi administruar pretendimet e personave përgjegjës të cilët në tërësi deklarojnë se: Të gjitha postimet kanë pasur të bëjnë me punën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe punën e institucioneve të varësisë. Janë publikuar investimet që ka bërë Ministria e Arsimit dhe Sportit në të mirë të komunitetit, si rindërtimi i shkollave, rindërtimi i godinave në qytetin student, lajme për inovacionin dhe shkencën, pra çdo gjë në funksion të arsimit dhe sportit. Duke marrë parasysh se këto veprimtari nuk janë kryer nga ana institucionale, por në mënyrë individuale nga persona që mund të mos kenë informacionin e duhur për këto, kërkojmë mirëkuptimin tuaj dhe vlerësimin e masave parandaluese në të ardhmen. Nuk kemi administruar ende përgjigje nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës. Palët në proces janë njoftuar për të marrë pjesë në seancën e sotme publike, për të parashtruar pretendimet e tyre në lidhje me çështjen objekt hetimi. Në seancën e sotme janë paraqitur, përfaqësuesit e:

- Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 19.02.2025*

- Agjencisë Kombëtare e Arsimit Parauniversitar.
- Drejtorisë Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë.
- Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, me rradhë nga e djathta në të majtë emrin, ju lutem dhe kë institucion përfaqësoni dhe pretendimet.

Z. A. Kalleshi, përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar

Tiranë: Përshëndetje, i nderuar Kryetar! Jam Arben Kalleshi, përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, me autorizim nga Bora Salaj. Në lidhje me denoncimin nr. 15 të KRIIK, për hashtaget e publikuara nga ana jonë, ne kemi paraqitur dhe prapësimet me email të cilave u qëndrojmë. Gjithashtu duam të theksojmë se nga ana e specialistit që janë bërë këto, nuk është dalluar, sepse te hashtaget nuk ka pasur asnjë shenjë dalluese, partiake që të vihej re se kjo ishte për parti politike. Gjithashtu, këto hashtage nuk kanë qenë nga ana jonë, por kanë qenë te faqja e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, e cila i ka publikuar. Ne kemi publikuar punët e ministrisë për rindërtimin e shkollave, për rindërtimin e kopshteve si dhe për shkencën dhe inovacionin të cilat i kemi bërë publike. Ju sigurojmë se pas marrjes së njoftimit nga KQZ-ja për këtë denoncim, ne kemi bërë të mundur fshirjen e të gjitha këtyre hashtageve si dhe kemi informuar të gjitha institucionet e varësisë për eliminimin dhe mospublikimin më, të tyre. Ju falenderoj!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Këto hashtaget kanë qenë të ministrit?

Z. A. Kalleshi, përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar

Tiranë: Po, si rasti i mëparshëm.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 19.02.2025*

Z. I. Celibashi: Flasim për ato me përmbajtje elektorale, dakord! Gjithësesi ju po thoni që i keni fshirë të gjitha hashtaget?

Z. A. Kalleshi, përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë: Po! Patjetër!

Z. E. Terpo, përfaqësues i Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar: I nderuar zoti Kryetar! Të nderuar anëtarë të administratës së KQZ-së! Unë quhem Edlir Terpo, përfaqësoj Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, në cilësinë e personit të autorizuar, por edhe të personit të kontaktit për raportimet në KQZ. Ashtu siç tha dhe parafolësi, jemi njohur me denoncimin e KRIIK Albania dhe kemi bërë dhe parashtrimet tona të cilat i kemi dërguar me email tek adresa “denoncime” dhe ju qëndrojmë tërësisht atyre prapësimeve. Me dy tre gjëra, mund të specifikoj që këto hashtage ishin pjesë e atij postimi të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe nuk kanë pasur këto logo simbolika, apo ngjyra karakteristike që mund të dalloheshin nga personat që kanë bërë shpërndarjen e këtyre në faqet e facebookut të institucioneve të tjera. Gjithashtu, në kuptim të pikës 2, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, ju garantojmë që nuk ka pasur asnjë rast të burimeve njerzore në funksion të fushatës elektorale, apo ofrimin e premtimeve në këmbim të pjesëmarrjes në fushatën elektorale të punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar. Në fokus të punës së Agjencisë Kombëtare, kanë qenë promovimi i arritjeve në investime, ose në fushën e arsimit parauniversitar, me fokus mësimnxënien dhe në këtë rast kemi postuar aktivitete të ministres, kryesisht në promovimin e arritjeve në shkolla, investime në infrastrukturën shkollore. Kryesisht

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 19.02.2025*

në laboratorin inteligjent me synim mundësinë që u jepet nxënësve për të përfituar njohuri të avancuara në lëndët: matematikë, shkenca, gjuhë shqipe, gjuhë të huaja. Në postimet që ka pasur Agjencia Kombëtare mund të kemi shpërndarë ndryshimet e akteve ligjore apo nënligjore në fuqi, apo edhe promovim të punës së intitucioneve të varësisë me fokus gjithmonë këto arritje. Gjithashtu, në fokus kanë qenë përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies me përfituesin kryesor që është nxënësi. Pas marrjes në dijeni dhe si të thuash pas klikimit vet të këtyre hashtageve, pasi askush nga ne nuk e dinte se këto kishin përmbajtje elektorale, është bërë fshirja e tyre nga të gjitha këto faqe dhe garantojmë që në të ardhmen nuk do të ketë mundësi të përsëriten më situata të tilla. Për këtë rast kërkojmë mirëkuptimin tuaj për një vendimarrje sa më objektive. Ju faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po zotëria tjetër!

Z. G. Janaqi, drejtor i përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar: Përshëndetje, i nderuar kryetar jam Gerti Janaqi, jam drejtor i përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar. Ne jemi njohur nëpërmjet email-it me denoncimin e paraqitur te ju nga KRIK me nr.15. Kemi analizuar gjithë procesin, jemi në të njëjtën kazus, duke gjykuar që ne dhe si sektor i arsimit parauniversitar përpiqemi të punojmë në ekip dhe në grup. Kemi bërë postimet dhe kemi ndarë gjithë elementët që ne na kanë ardhur nga faqja e Ministrisë së Arsimit dhe nga faqja e ministrit. Në rastin konkret agjencia është denoncuar për katër postime që në përmbajtje janë shumë teknike. Po të shihni fotot kanë të bëjnë me zhvillimin e laboratorëve për IT, ku ne jemi partnerë të implementimit edhe të monitorimit të cilësisë, ose trajnimi i mësuesve, apo investimi në infrastrukturë. Pa dashur t'ju marr kohë, sepse besoj së është e njëjta logjikë, kemi sjellë edhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 19.02.2025*

prapësimet. Kemi reflektuar, janë fshirë nga faqja jonë zyrtare të gjitha këto postime edhe për shkak të keqkuptimit që ne kemi pasur në lidhje me përdorimin e hashtagëve dhe besoj që në faqen tonë nuk gjenden më edhe në një periudhë shumë më të hershme se ç'kanë kanë qenë denoncimet.

Z. I. Celibashi: Faleminderit!

Z. Eugen Mino, përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar,

Fier: Unë jam përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar në Fier. Përfaqësoj zonjës Zaira Gjika e cila përmendet në denoncimin nr. 15. Kemi drejtuar prapësimet nëpërmjet adresës së email-it ditën e premte. Pak a shumë çështjet që janë ngritur në denoncim janë të njejta për të gjitha institucionet paralele. Në një faqe në facebook, e cila emërtohet si Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, Fier janë bërë postime nga një punonjës i ngarkuar me këtë detyrë, por jo zyrtare. Pasi nuk është e paguar, as aset publik, megjithatë përdoret në funksion të punëve që kemi ne. Nuk kam ndonjë gjë të veçantë për të shtuar nga prapësimet që kemi bërë, me përjashtim të një specifikimi dhe punonjësja nuk e ka ditur çfarë është hashtagu. Dmth nuk ka pasur njohuri teknike me mënyrën se si edhe të hiqej prandaj është eliminuar i gjithë postimi. Jemi të angazhuar që këto gabime, mund të themi të mos përsëriten më duke siguruar që do të respektojmë plotësisht Kodin Zgjedhor. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Dakord meqënëse këto hashtage ju i keni fshirë dhe keni vlerësuar që duhet të fshihen dhe konsideroni që nuk do të duhet që të ishin pasqyruar, edhe në këtë rast do të vendosim pushimin e shqyrtimit administrativ, pa i hyrë përmbajtjes në lidhje me natyrën e hashtageve. Faleminderit! **Vendim nr. 113**

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

